



Republika e Kosovës – Republic of Kosovo  
Komuna Hani i Elezit



02.nr. 10/21 /2022

Duke u bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Kosovës me nr. 03/L-040, neni 13 aktet e kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit, neni 61 dhe në bazë të nevojave të shtuara për dokumentacione nga Diaspora, Kryetari i Komunës nxjerrë:

**V E N D I M**  
**PËR ZGJATJEN E ORARIT TË PUNËS PËR SEKTORIN E GJENDJES CIVILE**

1. Obligohet Drejtoria për Administratë të Përgjithshme – Sektori i Gjendjes Civile me anë të këtij vendim që të bëhet zgjatja e orarit të punës për Sektorin e Gjendjes Civile nga data 15.12.2022 – 15.01.2022 me qëllim të ofrimit të shërbimeve për qytetarët e komunës sonë të cilët jetojnë dhe veprojnë jashtë shtetit, por edhe të atyre që jetojnë këtu.
2. Orari i punës (e hënë – e premte) do të jetë nga ora 08:00 – 16:00 dhe do të punohet edhe gjatë pauzës.
3. Do të punohet gjatë ditës së shtunë nga ora 09:00-12:00.
4. Për nëpunësit civil të cilët do të punojnë jashtë orarit të rregullt të punës të përcaktuar me këtë vendim të aplikohen dispozitat ligjore në fuqi (kompensim për orë shtesë apo shfrytëzim i ditëve të lira për numër të orëve të punës) .
5. Zyra për informim duhet të bëj publikimin e këtij akti dhe të publikoj atë në faqen zyrtare dhe në kanale të tjera komunikuese.
6. Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe do të ekzekutohet nga Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.

Data: 13.12.2022  
Hani i Elezit

Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit  
**Mehmet Ballazhi**



Me këtë vendim njoftohen:

- *Spektori i Gjendjes Civile*
- *Drejtoria për Administratë të Përgjithshme,*
- *Zyrës për informim,*
- *Arkivi i Komunës.*